



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENTI" (ish-Banka e Ljubllanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. nr. 667/22

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105 dhe nenit 106, nenit 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042), i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje nga Vedat Poterqoi–Kryetar, Agon Ramadani –referues, Kimete Gashi - Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik "Shkelqimi invest shpk" - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi dhe meremitimi i shkollave - Maqitevë; 7 Marsi dhe Komunë Lot 1 Renocimi i shf Sadri Duhia - Laxhja Sopaj; shf Besim Ndrecaj Maqitev dhe shf. Ismet Jashari-Kumanova Javor" me numër të prokurimit: 624-22-9770-5-2-1, iniciuar nga AK - Komuna Suharekë, me datën 12.12.2022 mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET** si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "Shkelqimi invest shpk" - Prishtinë, e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 17.11.2022 me numër të protokollit 667/2022, për aktivitetin e prokurimit: "Ndërtimi dhe meremitimi i shkollave - Maqitevë; 7 Marsi dhe Komunë Lot 1 Renocimi i shf Sadri Duhia - Laxhja Sopaj; shf Besim Ndrecaj Maqitev dhe shf. Ismet Jashari-Kumanova Javor" me numër të prokurimit: 624-22-9770- 5-2-1, iniciuar nga AK - Komuna Suharekë.

II. **Anulohet**, vendimi i AK lidhur me aktivitetin prokurimit, i përshkruar si në paragrafin paraprak të dispozitivit të këtij Vendimi dhe lënda kthehet në ri-vlerësim.

III. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informoj OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mos respektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarr masa ndaj AK sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.

IV. Parashtruesi i Ankesës ka të drejtë që ushtroj kërkesë për kthimin e mjeteve në afat prej 60/ditësh nga dita e prabninimit të këtij Vendimi, konform nenit 31 paragrafi 6 të Rregullores së Punës së OSHP.

A r s y e t i m

Me 28.10.2022, Autoriteti Kontraktues –Komuna e Suharekës ka publikuar Njoftimin për dhënie lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi dhe meremitimi i shkollave - Maqitevë; 7 Marsi dhe Komunë Lot 1 Renocimi i shf Sadri Duhia - Laxhja Sopaj; shf Besim Ndrecaj Maqitev dhe shf. Ismet Jashari-Kumanova Javor” me numër të prokurimit: 624-22-9770- 5-2-1.

Me 17.11.2022 OE “Shkelqimi invest shpk” - Prishtinë, ka parashtruar ankesë me (Nr. protokolli: 667/22), kundër njoftimit për dhënie të cituar si më sipër.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

OSHP ka angazhuar ekspertin shqyrtues të prokurimit, që në pajtim me nenin 113 të LPP ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore. Eksperti shqyrtues ka dorëzuar raportin e ekspertizës me 21.11.2022, duke i propozuar Panelit Shqyrtues që:

Ankesa e OE të refuzohet si e pabazuar;

Mbetet në fuqi vendimi i Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit;

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Përgjigje në pretendimin nr. 1

Eksperti shqyrtues sqaron se Operatori ekonomik “Shkelqimi invest shpk” - Prishtinë ankues me ofertën e tij ka dorëzuar listën e projekteve të realizuar gjatë tri viteve të fundit, mirëpo nuk ua ka bashkëngjitur dëshmitë e kërkuara siç janë kërkuar: Referencat ose procesverbalet e pranimi teknik apo raportet përfundimtare për pranimin e punëve të kryera për asnjërën nga kontratat të specifikuar në listën e dorëzuar për projektet e ngjashme të realizuara gjatë tri viteve të fundit.

Eksperti shqyrtues sqaron se në Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik- Nenin 38 Sqarimi i Tenderëve, tek 38.5 në të cilin thuhet “*Autoriteti kontraktues mund të ftojë Operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojnë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të LPP-së d.m.th dëshmitë e dorëzuara për kërkesat e përshtatshmërisë, kërkesat e përshtatshmërisë profesionale, gjendjes ekonomike dhe financiare dhe aftësisë teknike dhe profesionale, certifikatat e kualitetit, kërkesat e grupeve të OE. I cili është dhe pretendimi i OE*

ankues për këtë rast është i pa zbatueshëm sepse OE ankues nuk ka dorëzuar as një nga Referencat ose procesverbalet e pranimi teknik apo raportet përfundimtare për pranimin e punëve të kryera për as njërin nga kontratat të specifikuar në listën e dorëzuar siç kërkohen me 38.4 të po këtij neni, AK do të sigurojë mundësinë e sigurimit të informacionit shtesë në kushte të njëjta për të gjithë Operatorët ekonomik dhe do të kërkojë informacion nga Operatorët ekonomik me qëllim të qartësimit të përmbajtjes së deklaratave të paqarta certifikatave të përfshira në tenderë apo kërkesave për pjesëmarrje. Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i pa bazuar.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Ekspertit Shqyrtues i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa: “Shkelqimi invest shpk” - Prishtinë të merret si e pa bazuar, të mbetet në fuqi dhe AK-ja të vazhdoj me këtë aktivitet të prokurimit sipas procedurave të përcaktuara në LPP

Duke u bazuar në nenin 24 par.1 të Rregullores së punës së OSHP-së nr.01./2020 Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se në shkresat e kësaj lënde ka argumente dhe prova të mjaftueshme që vendimi meritor të merret edhe pa dëgjimin e palëve në seancë.

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët pohimet, PSH konstatoi se pretendimi ankimor i OE ankues është i bazuar për faktin se AK nuk ka vepruar konform nenit 39 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik (RRUOPP), për faktin se OE ankues ka dorëzuar listën e kontratave të vulosur dhe të nënshkruar konform kërkesës dhe dëshmisë sipas DT/Njoftimit për Kontratë.

Dëshmia1 –Listën në origjinal e vulosur dhe nënshkruar, të projekteve të ngjajshme të realizuara në tre vitet e shkuara nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, dhe dëshmitë e përfundimit Referencat ose procesverbalet e pranimi teknik apo raportet përfundimtare për pranimin e punëve të kryera.

Neni 39 i RRUOPP

Mungon referenca/certifikata e pranimi nga lista e kontratave të prezantuar	Mund të kërkohen informata sqaruese	69
---	-------------------------------------	----

Po ashtu, paneli shqyrtues konsideron, se autoriteti kontraktues nuk ka vepruar konform Neni 7, Neni 59, Neni 60 dhe Neni 72 të LPP-së.

Bazuar në kompetencat e OSHP të parapara me nenin 105, lidhur me nenin 106 të LPP, Paneli Shqyrtues vuri në zbatim mes tjerash dhe nenin 103 të Ligjit të cituar sipas të cilit të gjitha palët e interesuara do të kenë qasje të barabartë në procedurat për shqyrtimin e prokurimit dhe në mjetet juridike dhe se, asnjë vendim i OSHP, nuk do të merret ose bëhet në mënyrën me të cilën diskriminohet në të mirë ose në dëm të një pjesëmarrësi në procedurë ose të një personi ose ndërmarrje tjetër.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, në pajtim me nenin 117 të LPP.

Kryesues i Panelit Shqyrtues

Vedat POTERQOI

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK – Komuna e Suharekës;
- 1x1 OE - “Shkelqimi invest shpk” - Prishtinë;
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.